

V E N D I M
Nr. 213, datë 16.5.2002

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 82, DATË 26.2.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME KONCESION TË MINIERËS SË
KROMIT BULQIZË, TË FABRIKËS SË PASURIMIT BULQIZË, TË IMPIANTIT TË
SELEKSIONIMIT KLOS DHE TË UZINËS SË FERROKROMIT, BURREL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr. 7973 datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 82, datë 26.2.2001 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Pas pikës 3 shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

“3.1. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj kontrate.”.

2. Pika 5 ndryshon si më poshtë vijon:

“5. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko